

25.11.1999, FDH-27721; USCG KGDH, *Regjistri...*, FDH-8817; SMIP, *Teroristički...*, III, 906; KKMKRFJ, *Personat...*, FDH-10832; *Dnevnik od 5. do 9. avgusta*, Ilustrovana politika, FDH-31289.

### Adem (Sadik) Brahimaj

(1918, shqiptar nga Kralani/Kraljane, komuna e Gjakovës/Đakovica, tetë fëmijë)

Në datën **5.08.1998**, nga ora 10:00, policia serbe hyri në Kralan/Kraljane. Filluan me vënien e zjarrit në shtëpitë e fshatit. Bashkëshortja e Ademit, Kaja, djemtë, të rejtat dhe nipërit, si dhe fshatarë të tjerë u zhvendosën në pyllin e afërt, te vendi i quajtur *Lugu i Arave/Dolina njiva*. Pas disa orësh, kur dëgjuan se policia u tërhoq nga fshati, djali i Ademit, Seferi, i vëllai dhe tre komshinjtë u kthyen në **Kralan/Kraljane**. E gjetën trupin e pajetë të Ademit në një livadh pranë shtëpisë familjare. I kishte plagët e panumërta nga plumbat. E varrosën menjëherë në vendin ku e gjetën. Varri i tij gjendet edhe sot në të njëjtin vend.

**Burimi:** deklarata S.B, FDH-16459.

### Nebojša (Svetomir) Savić

(5.06.1967, serb nga Vlladiçin Hani [Serbi], një fëmijë, pjesëtar i MPB-së së Republikës së Serbisë)

Nebojša, i quajtur Mitke, jetonte në Vlladiçin Han me bashkëshorten Suzanen dhe djalin Milovanin, 1 vjeç. Ishin qiraxhinj. Ai punonte në SPB-në e Vlladiçin Hani. Në Kosovë ka shkuar më 10.07.1998. Ishte i dislokuar në postbllokun policor në fshatin Rakovinë/Rakovina. Nga mesnata e datës **5.08.1998**, mbi shtëpinë në të cilën ishin të sistemuar policët [**Rakovinë/Rakovina**], janë shkrepur dy gjyle nga topi, një nga të cilat e ka qëlluar nën-kulmin ku në ato çaste ndodheshin Nebojša dhe një policë tjetër. Nebojša mbeti i vdekur në vend, ndërsa polici tjetër vetëm u plagos. Nebojša u varros në varrezat e vendlindjes në fshatin Manjak [Vlladiçin Han], më 7.08.1998.

**Burimet:** deklarata S.N, FDH-30754; Prokuroria Publike e Qarkut Peç, IT-br.216/98 (Hereqi

dhe të tjerë), aktakuza, 9.03.1999, FDH-1366; Politika, Nebojša Savić, përkujtimi në shtyp, 7.08.1998, FDH-20740; Gjykata e Qarkut Leskovac K.br. 152/99 (Naim Kida dhe të tjerë), aktgjykimi, 23.06.2000, FDH-1362; FHP, *Haški tribunal, Sudeenje Slobodanu Miloševiću*, III, 119; SV SRJ, *Junaci otadžbine*, 62; SMIP, *Teroristički...*, III, 937; USCG KGDH, *Regjistri...*, FDH-8817; KKMKRFJ, *Personat...*, FDH-10832.

### Galan (Metë) Meka

(1937, shqiptar nga Kralani/Kraljane, komuna e Gjakovës/Đakovica, murator, pesë fëmijë)

Galani ka mbetur vetëm në shtëpi [**Kralan/Kraljane**], kur policia serbe hyri në fshat më 5.08.1998. I biri Azemi me nënën, bashkëshorten dhe fëmijët u strehua në pyllin e afërt të quajtur *Lugu i Arave*. Në datën **7.08.1998**, në orët e pasdites, Azemi vërejti nga pylli se policët serbë hyrën në shtëpinë e tyre. Pas dy ditësh, ai u kthye fshehurazi në shtëpi. Trupi i pajetë i të atit gjendej në oborr, i zhytur në gjak. U kthye sërish në pyll dhe nënës dhe të tjerëve u tha se Ademin e kishin vvarë. Një javë më vonë, më 15.08.1998, kur policia serbe u largua nga fshati, familjarët e kanë varrosur Ademin në varrezat lokale.

**Burimi:** deklarata A.M, FDH-16458.

### Mark (Tunë) Lleshi

(25.04.1926, shqiptar nga Vraniqi/Vraniç, komuna e Gjakovës/Đakovica, bujk, njëmbëdhjetë fëmijë)

### Kolë (Gjon) Lleshi

(15.03.1967, shqiptar nga Vraniqi/Vraniç, komuna e Gjakovës/Đakovica, bujk, një fëmijë)

Familja e Markut kishte probleme me pushtetin komunist në ish RSFJ-në që nga demonstratat e vitit 1981. Për këtë arsye, djemtë e Markut e kishin braktisur vendin. Në mars të vitit 1998, Marku me djemtë Pjetrin dhe Martinin, si dhe kushëririn Kolën, u armatosën. Ata, po ashtu, nisën të ndihmonin UÇK-në, duke marr pjesë në mbrojtjen e fshatit. Kur, më **7.08.1998**, forcat serbe depërtuan në fshatin **Vraniq/Vraniç** nga drejtimi i fshatit Meqe/Meçe, duke shtënë mbi shtëpinë e Markut, ai dhe djemtë e kthyen zjarrin. Në ato çaste, Kola